

KUNGATORJA

Fama e tij u-perháp ne tere boten.

SHENIM. Si Shen Gjergji, ashtú edhe Shen Marku, kur bie ne Kreshmet e Medhá, kremtohet pas Pashkes.

26. Basileu, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Amasise.

27. Simeoni, Hierodeshmori i Shenjte, Kusheriri i Krishtit, peshkopi i Jerusalemit.

PERLGSHORJA E SIMEONIT TG JERUSA-
LEMIT, T. I, KHOROS ANGELIKOS

Gjirí me Zotin Krisht, Simeón i bekuar, shkelqeve si Deshmór, perandáj te hymnojme, se shtype çdo heresi, edhe besen e ngrite lart, sot pra mblídhemi, dhe te kremtojme me besë, dhe te lútemi, te na dhurósh perdellím, dhe ndjesen e mekátave.

28. Te Nente Deshmoret e Shenjte te Kizikes.

29. Jasoni dhe Sosipatri, Apostujte e Shenjte.

30. Jakobi, Apostulli i Shenjte, i velláj i Shen Joán Theollogut.

PERLGSHORJA E JAKOBIT APOSTULLIT,
T. III.

Jakób Apostúll i Shenjte, lutju Zotit tone Jesús Krisht, tu fale shpírteve tona, ndjesen e mekátave.

TE KREMTET E MAJIT

1. *Jeremia, Profeti i Shenjte.*

PERLESHORJA E JEREMISE, T. II.

Jeremí Profét, qe te kremtojme me besë, nermjetó perpara Zotit, te shpctohen shpirtet tona.

2. *Trasferimi i lipsanit te Thanasit te Math, Atit tone te Shenjte, kryepeshkopit te Aleksandrise.*

PERLESHORJA E SHEN THANASIT, T. III, THIAS PISTEOS

Shtyllc ne termét per fen' e drejte, na u-çfaqc ti se e permbajte, Kishen dhe shtype Ariosin heretik perdhé; dhe Shpctimtarin e botes dhe Birin Krisht, te bashkeqenshim me Atin e çpalle ti. Ate Oshenár, pra lutu perpara Zotit Krisht, te na dhuronjc ndjesen e mekátave.

3. *Timotheu dhe Mavra, Deshmoret e Shenjte.*

4. *Pellagia, Deshmorja e Shenjte.*

5. *Shen Irena, Deshmorja e Madhe.*

PERLESHORJA E IRENGS SG MADHE, T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Shqerra jote o Jesú, me zc te math po te therrét: Dhenter ty te desherónj, dhe nat' e dite te kerkónj, dhe kryqesohem dhe varrosem tok me Pagezimin; edhe vuanj tok me ty, qe te gczohem tok me ty, edhe vdes per emrin tcnt, qe tok me ty te rronj ne qell; po si nje fli te shenjte prit-me

mua qe per ty sakrifikohem. Dëgjona lutjet, e-dhe shpëtoji, shpirtet tona prej vdekjes.

6. *Jobi i Shenjte dhe i Drejte.*

7. *Kujtimi i Shenjes se Kryqit, qe u-duk ne qytetin e Jerusalemit.*

PERLESHORJA E SHENJES SE KRYQIT, T. I.

Shenj' e Kryqit taní ka ndritur mi dhene si dielli, se e përhapë mi qellin, prej Golgothasë gjer në Sión, dhe kështú tregove forcën qe ke o Shpëtimtár, dhe kështú i forcove të gjithë krerët e besnikëve; ti pra përkih-i dhe mproj-i përherë në paqe, me lutjet e Shen Marisë o Krisht Përendí, dhe ti na shpëtó.

8. *Shen Joani Theologu, Apostulli dhe Ungjillori i lavderuar; Arseni i Math, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E JOANIT UNGJILLORIT, T. II.

O Apostull i dashur i Krishtit, eja dhe shpëtoje pópullin e deshperuar; lutjet e tua i pret aý, qe i ke rene mi kraherorin; o Theollóg atí kerkoji, t' i përndanje ret' e barbáreve, dhe të na fale paqen, dhe përdellimin e math.

PERLESHORJA E ARSENIT TE MATH, T. T. IV, TES TON DHAKRION SU

Me lote derdhur si reké, shkretëtirën e that' e vadite për lërim, dhe me vajtim dhe psherëtim, gjer një qint herë peme mblodhe për çdo mundim; u-çfaqë pra si yll, dhe e ndriçove botën me

çdo çudí, Arsén i Shenjte Atë dhe Oshenár, lutju Zotit Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

9. *Isaia, Profeti i Shenjte; Kristofori, Deshmori i Shenjte.*

PERLESHORJA E ISAISE, T. II.

Isaí Profét i Shenjte, që të kremtojmë me besë, nermjetó përpara Zotit, të shpëtohen shpirtet tona.

PERLESHORJA E SHEN KRISTOFORIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Stolisur me bukurí, skuqur me gjakun tënt, i lumur në qell qëndrón, përpara Mbretit Jesú, Kristofór i kujtúarshim, dhe me gjithë Deshmorët, dhe me Engjëjt' e Shenjte, po këndón Trishenjtorin, pranë frontit të Zotit. Për në pra nermjetó gjithënjé, të shpëtohen shpirtet tona.

10. *Simoni Zelloiti, Apostulli i Shenjte.*

PERLESHORJA E SIMON ZELLOTIT, T. III.

Simón Apostúll i Shenjte, lutju Zotit tonë Jesú Krisht, tu falë shpërteve tona, ndjesën e mekátave.

11. *Themelimi i Kostandinopojës; Moqi, Hierodeshmori i Shenjte.*

12. *Epifani, Ati ynë i Shenjte, peshkopi i Kipros; Gjermani, Ati ynë i Shenjte, peshkopi i Kostandinopojës.*

13. *Gliqeria, Deshmorja e Shenjte.*

14. *Isidori i Kios, Deshmori i Shenjte.*

15. *Pakomi i Math, Ati ynë Oshenár; Akili Çudibéresi, Ati ynë Oshenár, kryepeshkopi i Larises.*

PERLESHORJA E PAKOMIT TG MATH,
T. T. IV, TES TON DHAKRION SU

Me lote derdhur si reké, shkretetiren e that' e vadite per lerím, dhe me vajtím dhe psherétím, gjer nje qint here peme mblodhe per çdo mundím; u-çfaqe pra si yll, dhe e ndrìçove boten me çdo çudí, Pakóm i Shenjte Ate dhe Oshenár, lutju Zotit Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

16. *Theodori i Shenjteruar, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E THEODORIT TG SHENJ-
TERUAR, T. I, TU LITHU SFRAJISTHENTOS

Qytetár i shkretetires edhe Engjell nga trupi, edhe çudiberes u-çfaqe, Theodór o At' i Shenjte; me lutje vengjill' e agjerím, fitove dhuretí te qëll-shime, se semundjet dhe lengatat na i sherón, dhe ndjen mekatat e shpirtit; lavdí atí qe te fali fuqí; lavdí atí qe te dha kurore; lavdí atí qe veperón me anen tende sherime.

17. *Androniku dhe Junia, Apostujte e Shenjte.*

18. *Pjetri, Dionisi, Kristina, Andrea, Pali, Benedimi, Pavlini, dhe Herakleu, Deshmoret e Shenjte.*

PERLESHORJA E DESHMOREVE,
T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmoret e tu o Zot, me vojtje lot e mundím, kurore te ndrìçime prej teje múarne, si roge dhe si çperblím; se me fuqine tende, i rrezuan tiranet; edhe i shtypne djajte, e kuxímt' e te dobet;

atá per né po te luten o Krisht Perendí, te shpctohen shpirtet tona.

19. *Patriqi, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Bru-ses, dhe shoket e tij, Akaqi, Menandri dhe Polieni.*

20. *Thaleleu, Deshmori i Shenjte.*

21. *Shen Kostandini dhe Shen Elena.*

PERLGSHORJA E SHEN KOSTANDINIT,
T. T. IV.

Kryqin tent te çemuar, te pikturuar ne qell e pá, dhe si Shen Pali e mori, ftimin e shenjtc qc lártazi, dhe u-tregua, i pari Apostúll dhe Mbret, edhe tere Mbretetere te Krishtere ta dorezój; pra na ruaj perhere ne paqe, me lutjet e Shen Marise, ti njeridáshesi.

THIRRTORET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Arme te fort' i dhé, Shen Kostandinit Kryqin, dhe mbretetérój mi dhene, dhe trashegój Parajsen, o Zoti Krisht o Shpetimtár.

Shpirt prej Davidi i dhe, dhe mendje Sollomoni, dhe besë Apostulli, e bcre mbret mi mbreter, o Zoti Krisht o Shpetimtár.

Mbret o Shen Kostandín, te pagezój Silvani, dhe boten trashegove, dhe ia dhurove Krishtit, perhere nermjetó per né.

LAVDI. Fronin ta dorezój, dhe shtetin Kostandini, si Perendí te njohu, dhe Mbret te gjithesise, o Zoti Krisht o Shpetimtár.

TANI, e *Pesedhjetores.*

PASVARGJET, T. II, OTE EK TU KSILU

Dolle o i Shenjtë Kostandin, Mbreti i Krishterë i parë, fitove nder e lavdi, ty t'u-çfaq e t'u-fanës simból' i fshehur në dhé, Kryq' i Shenjt' i besníkeve, i cili të ndihu, që të mbretërosh kudó nga Roma gjer në Stambóll; armë të pamundur e pate, Kryqin Kostandin i trishlumur, me atë na ndrite pranë Zotit Krisht.

Nena që të mbajti në peqí, Shen Elena është e lumur, se të ka patur si bir, mbret i gjithë mbretërve Shen Kostandin që gezón, zemrat e të Krishtërve, lavdia e Romës, mprojtes edhe perluf-tár për çdo jetím dhe të ve; strehë për të mjeret e botes, mjek për çdo lengát' e semundje, çlirim-tár i gjithë të burgósurve.

Besë edhe mall për Zotin Krisht, Shen Elena nëna e lumur, e Kostandinit me nam, pati edhe shkoj me vrap në mal të shenjtë Sión, n' atë vent ku pesój për né, dhe u-kryqësua, Zoti ynë Jesú Krisht që të na falë shpëtím; dhe atjé më gas lart e ngriti, dhe të lavderonte me bujë, se e gjeti Kryqin e besníkeve.

LAVDI. Kryqin e pé në qell, dhe Krishtin e besove, dhe fen' e shigurove, dhe lart në qell fitove, kuroren e Shenjtóreve.

TANI, e *Pesedhjetores*.

NDËNJËSORET, T. III, THIAS PISTEOS

Si David i ri, Mbret i dëgjuar, që prej qiellit, more kuroren, dhe u-mirose prej Zotit o mbret i

math; se Shpirt' i Shenjtë me vajin të lyejti, dhe të bekój Shpetimtari dhe Zoti Krisht; zure fronin pra, si mbret i par' i besnikëve, dhe lutesh gjithënjë, për ndjesën e mekátave.

LAVDI DHE TANI, e *Pesedhjetores*.

T. IV, EPEFANIS SIMERON

Me fuqin' e Kryqit tënt, Díell' i botës, hoqe yllin Kostandin, edhe e bëre mbret me nam, pra i thërrsim me zë të math: Me Shen Elenën, shpetona prej tmërreve.

LAVDI DHE TANI, e *Pesedhjetores*.

T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Me bujë kujtimi yt, na është çfaqur sot, i ndrit gjithë njërezit, me dritë dhe dituri, o i lumur Shen Kostandin, se ti na je treguar, i Krishtere me besë, dhe ke rúajtur ligjat, që na dha Mbret' i qellit; pra lutu dhe shpetona gjithënjë, prej hëlmeve dhe ngásjeve.

LAVDI DHE TANI, e *Pesedhjetores*.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Që prej djalerisë, shumë pasione më leftojne, po ti perkrah-më dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju që urreni Sionën, do të turpërohëni prej Zotit, dhe do të físhkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, merr jetë çdo shpirt, dhe lartësohet në paqësi, dhe ndriçohet prej njesisë Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin

burimet e hirit, dhe vaditin tërë kriescn për jetelindje.

PAREVARGU. E lartësova të zgjédhurin prej pópullit, e gjeta shërbëtorin tim Davíd, edhe e leva me Vajin e Shenjtë.

UNGJILLI PAS JOANIT

Zoti tha: Une jam dera. Aý, që hyn me anën time, do të shpëtonjë, dhe do të hynjë, dhe do të dalë, dhe do të gjenjë kullotjë. Kusari nukë vjen veçse për të vjedhur, për të thërrur dhe për të humbur, po unë kam ardhur që tju jap jetë dhe tju jap jetë të tepër. Une jam bariu i mirë. Bariu i mirë ve shpirtin për dhentë. Po rogetari, i cili nuk është barí, dhe nuk i ka të tija dhentë, e sheh ujkun, që vjen, edhe i le dhentë, dhe iken, dhe ujkun i rembén, edhe i çkaterrón dhentë. Dhe rogetari iken, se është rogetár, dhe nuk e ha mallin për dhentë. Une jam bariu i mirë, dhe i njoh të miat, edhe të miat me njohin. Sikunder me njëh im Atë, edhe unë e njoh Atin, edhe ve shpirtin për dhentë. Kam edhe dhen të tjera, që nukë janë prej këti hoberri, edhe duhet t' i siell edhe ató; edhe do ma degjojnë zerin, edhe do të bëhen një kopé dhe një barí.

Psalmi 51 pa ze.

LAVDI. Me nermjetimet e Kurorëprúresve, o meshireplót, shúaji paudhësít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhësít' e mia.

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.

T. II. Mbretin Shen Konstandín, dhe Shen Elenen lusim, se Krishtin e besuan, dhe lart në qell fituan, kuroret e Shenjtóreve.

SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS

Kostandini mbret me nam, tok me Elenen e Shenjte, e zbulojnë Kryqin sot, simbolin e lavdëruar, tmerr dhe vrer, për të pabesët edhe paganët, arm' e shqyt, për të Krishterët kundër armiqve, së u-çfaqë për besnikët, një shenj' e lartë dhe lavdiprúrese.

SHTËPIA

Le t'i nderojmë të dy Shenjtoret e kurorëzuar, Shen Kostandinin dhe Shen Elenen, se e besuan Krishtin, e perkrahën fenë, e shiguruan Kishën, dhe e zbuluan Kryqin, armen e pamundur, shenjen e lartë dhe lavdiprúrese.

SINAKSARI

Me njëzët e një të ketí múaji, kujtojmë Shen Kostandinin dhe Shen Elenen, Mbréterit e mëdhénj, të lavdëruar dhe Isapostúj.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirona. Amín.

Negóftese e kremtja bie përpara Shestjes, këndohen Zbritësoret e Pashkes:

ZBRITËSORET, T. I, ANASTASEOS IMERA

I. Dit' e Ngjalljes sot na ndriti, ngazellóhuni

pra, Pashka e Zotit Pashka; se ja prej vdekjes jeta vjen, dhe prej dheut lart ne qell, na shpuri me kenge mûndese Zoti Krisht, Shpetimtari i shpírteve.

III. Eni pini uje krejt te re, qe s' e nxori prej shkembít, shkopi çuditerisht, po qe burón si reké, nga varri i Zotit Jesú Krisht, i cili na fal shcrím.

IV. Nga fron' i qellit o Profét, perendifoles Abakúm, eja sot me né dhe tregona, driten edhe Engjellin, i cili sheshit lajmcron: Sot i ka ardhur shpetimi botës, se Jesú Krishti u-ngjall, si Perendí dhe Zot.

V. Mengoni me nate dhe eni, dhe le t' i shpiem kendime, si myrre Zotit ne varret, dhe do ta shikojme Krishtin, díellin qe u dhurón, jeten dhe paqen te gjithëve.

VI. Kur zbrite gjer ne funt te dheut ne Ferr, dhe dermove gjithë llozet e burgut, çlirove skllvet e jéteve, edhe pas tri ditsh prej balencs si Jonáj, dollë jashte nga varri.

VII. Tre Djemat midis flagës i mproj me shi, dhe vete u-be njerí, dhe pesój si né, dhe me pesím shpetimtár, na stolisi me jeten qe nukë vdes, i vétëmi Perendí i bekuar, i Aterve lavdí me ty.

VIII. Dit' e sotme është e shenuar e shenjtc, e para dit' e javës, qe mbretcrón mi te kremtet, permi dhene kudó, panair i panairëve lart ne qell; sot pra e bekojme, per jete Jesú Krishtin.

Nje Engjell i therriste, hirplotes pa pushuar, gezohu

*Virgjereshe, dhe prape te thom gezohu, se Biri yt u-ngjall
qe prej varrit i tridicim.*

IX. Ndricohu ndricoju, qytét i ri Jerusalém,
se lavdia e Zotit, permi ty ka lindur sot. Valle ke-
cé, dhe gezohu Sión, ti o Marí, Nen' e Perendise
dçfré per ngjalljen e Birit tent.

*Neqóftese e kremtja bie pas Shestjes, atehere kendohen
Zbritesoret e Shestjes:*

ZBRITCSORET, T. IV, THIO KALIFTHIS

- I. Mjegull e mbulój belbecakun mi malin
Kur e proklamój ligjen e Perendise,
Se e hodhi tej erresiren e mendjes,
E pá te Lartin dhe prej Shpirtit i ndrícuar
Mori dijen dyke lavderuar Zotin.
- III. Lithmen e çlirój te beronjes pa foshnje,
Talljen e pellores me femije shume,
E pushój nje here profetesha Anna
Me te fálura, me fryme te dermuar
Perpara Perendise Zotit te meshires.
- IV. Mbret i mbréterve, dhe Bir i Vetem-
lindur,
Fjal' e Perendí prej Atit te panisme,
Shpirtin e bashkefuqíshm' e te pavdekur
U dergove Apostujve per leçitjen,
Dhe atá kendonin: Zot lavdí me ty.
- V. Ndjes' e paqesím per faje dhe mekata
Prisni prej Shpirtit vesen e frymezjarrte
Bij te Kishes me fytyre te ndrícuar,
Se taní na dolli ligja nga Siona,

Hir' i Shpirtit Shenjt me gjúhera prej
zjarri.

- VI. Qe te na shpëtósh dhe te na ndjesh me-
katat,
Linde permi dhé si Zot prej Virgjereshes,
Dhe si Profetin Shen Joná prej mush-
kerive
Te balenes ta shpëtósh edhe njerine,
Te rrezuar dhe te mbytur nga mekatat.
- VII. Krisi me nje ze nje kenge me strumenta,
Per adhurimin e statujes njerezore;
Po Ngushellimtari na ndriçon me hir
Edhe na fton te themi: O Triní e vetem,
E Shenjte, e panisme, e bekuar je.
- VIII. Çdo zinxhír e zgjith edhe çdo flag' e
shuan,
I tridriteshmi simból i Perendise.
Hymnojne djemat, dhe e bekojne Zotin,
Shpetimtarin krijetar si mireberes
Gjithe veprat qe i ka krijuar vete.

*Engjejte, kur pane Shestjen e Zotit, çuditeshin dhe
shtángeshin, qysh me lavdí fluturonte, qe prej dheut ne
te lartat.*

- IX. O Hyjlíndese Virgjereshe dhe Nene,
Gjuha mé e mprehte dhe oratorike
Nuke munt te te kendonje sipas vleres,
Dhe vertikohet mendja per lindjen
tende;
Pra me nje ze te gjithe te lavderojme.

DERGIMCSORET, T. II, TIS MATHITES

Nuk e mori nga njërezit, fuqin' e mbreterise, po nga dhurat' e Shpirtit Shenjt, Kostandin' i degjuar, tok me Elenen e Shenjte, dhe keshtu e pa Kryqin, qe shkrepentine lart ne qiellin, me ate i permbysi armiqt' e liq, edhe fen' e rreme te paganizmes, edhe ne boten e forcój, fen' e Orthodoksise.

Pastaj e Pesedhjetores.

LAVDERIMET, T. T. IV, O TU PARADHOKSU

Lum ti Kostandin o Shenjt i Math, ti o burim Orthodoks, qe vadit dhe qe ngazellon, neper boten çdo besnik, me te pira te embela; lum' ti qe mbive, renjat e pemeve, qe po ushqejne, Kishen e Zotit Krisht; lum' ti o themeli, e te gjithë Kiseve kudó mi dhé, o i par' i mbréterve, qe na gczon gjithenjë.

Prite me verejtje nga Jesúj, mcsim edhe predikim, si nje ar' e çudicime, e leruar me kujdes, dhe e zgjedhur prej Zotit Krisht; edhe u-bere, kopsht' i virtutave, o Shen Elenc, mburrj' e besnikeve; pra ta kremtojme sot, me gczim dhe ngazellim kujtimin tent, nen' e Kostandinit Math, mbretit te mbréterve.

Ti o Perendi i lyejte, me vaj dhe me ngazellim, dhe i vure te dy ne fron, Apostullin Mbretin Shenjt, edhe nenen e tij me nam; qe na e gjetne Kryqin e Zotit Krisht, dhe themeluan, besen e tij mi dhé; roge pra múarne, Mbreterin' e qiellit qe

s' ka mbarím, pranc teje me lavdí, me gjithë En-gjejte.

LAVDI, T. T. IV. Mbreti i mbréterve, Perendia dhe Zoti, të fitój o Shen Kostandín si Palin, me shenjen e Kryqit nga qíelli, dhe me até i dermove armiqtë, dhe até pastáj e kerkove, dhe e gjete me Shen Elenen. Ju lútemi nermjetoni, që të dy perpara Perendisë, për shpetimin e besnikëve.

TANI, e *Pesëdhjetores*.

HYRTORJA

Neqóftese e kremtja bie perpara Shestjes, këndohet Hyrtorja e Pashkes:

Në Kishet e bekoni Perendinë, Zotin prej burimit të Israelit. Shpetona o i Bir' i Perendisë, që u-ngjalle së vdekurësh, né që të këdojmë Alluia.

Neqóftese e kremtja bie pas Shestjes. atehere këndohet Hyrtorja e Shestjes:

Perendia u-ngjitet me brohorí, Zoti me bujë prej trumbete. Shpetona o i Bir' i Perendisë, që u-shestjove në qell me lavdí, né që të këdojmë Alluia.

Gjithashtú këndohet edhe Shkurtorja e Pashkes, neqóftese e kremtja bie perpara Shestjes, edhe Shkurtorja e Shestjes, neqóftese e kremtja bie pas Shestjes:

SHKURTORJA E PASHKES, T. T. IV,
I KE EN TAFO

O i pavdekur që zbritë në varr për né, ti e der-

move Sketerren o Zot perdhé, dhe u-njalle si fitimtár o Krisht Perëndí, edhe Grave me myrra u thirre Gëzohuni, dhe u dhurove paqen qellore Dishépujve, ti që u fale Ngjalljen të rëneve.

SHKURTORJA E SHESTJES, T. T. II, TIN IPER IMON

Passi e mbarove punen për në mi dhene, dhe si i pajtave njërezit me të Lartin, fluturove në qellin o Krisht Perëndí dhe Zot, po s' u-ndave prej Dishépujve, se qendrón përherë tok me në, se u thë me mall besnikëve: Ja unë jam me ju, dhe asnjë kundër jush.

APOSTULLI

Fama e tyre u-perháp në tërë botën. Qelli tregón lavdinë e Perëndisë.

Prej Akteve të Apostujve.

M' ató ditë, mbreti Agrippa i tha Palit: "Ke leje ta mprosh veten." Atëherë Pali ndeu dorën, edhe tha: "Tek po shkonja në Damaskë, o mbret, me fuqí dhe me misión prej kryepërfiterve, pashe në mes të ditës një dritë, më të shkelqyer se të diellit, e cila më rethój mua dhe atá, që udhëtonin me mua. Dhe që të gjithë rame perdhé, edhe degjova një zë, që më fliste, dhe më thoshte në gjuhën hebraishte: "Saúl, Saúl, përse më ndjek? Është zor të shkelmósh kundër gjëmbave." Dhe unë e pyeta: "Cili je ti, o Zot?" Edhe aý u-përgjéq: "Unë jam Jesúj, që më ndjek ti. Po ngrehu, dhe qendró me këmbë. Se perandáj t' u-fanesa

qe te te dorezónj sherbetór dhe deshmór per ató, qe pé taní dhe qe do te tregónj mé vonc, dhe te kam zgjedhur prej pópullit edhe prej pagáneve, ne te cilet po te dergónj taní, qe tua çelesh syte dhe te kthehen nga errësira ne driten dhe nga fuqia e Satanit me Perëndine, dhe te marrin ndjesen e mekátave, dhe trashëgimin e Shenjtóreve me anen e bescs sime.” Perandáj, o mbret Agrippe, u-binda ne keté urdher, qe mora me nje viziÓN nga qelli, dhe mé parc ne Damasko dhe ne Jerusalém, edhe pastáj ne tere Judene dhe ne paganet, leçita qe te pendohen dhe te kthehen me Perëndine, dyke provuar pendimin me vepra te perkatme.

UNGJILLI I MËNGJESIT PAS JOANIT

Zoti u tha Judenjve, qe i kishin ardhur: “Me te vertete, me te vertete po ju them: Aý, qe nuk hyn nga dera ne hoborin e dheneve, po ngjitet gjétkazi, aý eshte vjedhes edhe kusár, edhe aý, qe hyn nga dera, aý eshte bariu i dheneve. Atí ia hap deren portari, dhe aý i therrét me emer dhente, dhe i nxier jashte. Dhe kur i nxier jashte dhente, barét perpara atyre, dhe dhente i vene pas, se ia njohin zerin. Se nuk i vene pas nje te húaaji, po ikin prej tij, se nuk ua njohin zerin te húaajve.” Keté parabolle ua tha Jesúj, po nuk i múarne vesh ató, qe u thoshte. Jesúj, pra, u tha perserí: “Me te vertete, me te vertete po ju them se une jam dera e dheneve. Te gjithë atá, qe kane

ardhur perpara meje jane vjedhes edhe kusare, edhe dhente nuk i degjuan. Une jam dera. Aý, qe hyn me anen time, do te shpetonje, dhe do te hynje, dhe do te dale, dhe do te gjenje kullotje.”

KUNGATORJA

Fama e tyre u-perháp ne tere boten.

22. *Basilisku, Deshmori i Shenjte.*

23. *Mehilli, Ati yne Oshenár, peshkopi i Sinádave.*

PERLESHORJA E MEHILLIT TE SINADAVE, T. T. IV, QE TROPON METOKHOS

Shok i menyrave, nekembes i fróneve, u-çfaqe kor' e Dishépujve, zbatove me veperím kudó, çdo teorí edhe predikím; perandáj te verteten e leçite prer' e drejt, dhe per besen leftove gjer ne gjak, si nje Deshmór o Shen Mehíll; lutju Zotit Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

24. *Simeoni i Thavmastit, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E SIMEONIT TE THAV- MASTIT, T. I, TU LITHU SFRAJISENTOS

Qytetár i shkretetires edhe Engjell nga trupi, edhe çudiberes u-çfaqe, o Simeón i Shenjte; me lutje vengjill' e agjerím, fitove dhuretí te qëllshime, se semundjet dhe lengatat na i sherón, dhe ndjen mekatat e shpirtit; lavdí atí qe te fali fuqí; lavdí atí qe te dha kurore; lavdí atí qe veperón me anen tende sherime.

25. *Gjetja e trete e Kokes se Shen Joanit Pagezorit.*

PERLESHORJA E SHEN JOANIT PAGEZORIT T, IV, TAKHI PROKATALLAVE

Si nje thesár mistík, qe ishte fshehur ne dhé, ta gjeti Zoti Jesú, koken e shenjte pa çmim, Profét Pagezór Joán; mblídhuni pra te gjithë, ta kremtojme me bese, eni ta lavderojme, Zotin le ta hymnojme, i cili na shpctón prej prishjes me nermjetimin tent.

26. *Karpi, Apostull i Shenjte, nje prej te Shtatedhjte Apostujve.*

27. *Helladi, Hierodeshmori i Shenjte.*

28. *Eftiku, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Melitines.*

29. *Theodosia, Deshmorja e Shenjte.*

PERLESHORJA E SHEN THEODOSISE, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmorja jote o Zot, me vojtje lot e mundím, kurore te ndrícime prej teje mori sot, si roge dhe si çperblím; se me fuqine tende, ka rrezuar tiranet, dhe ka dermuar djajte, e kuxímt' e te dobet; ajó per né po te lutet o Krisht Perendí, te shpctohen shpirtet tona.

30. *Isaaqi, Ati yne Oshenár, abati i Manastirit te Dalmáteve.*

31. *Hermeu, Deshmori i Shenjte.*

TE KREMTET E QERSHORIT

1. *Justini Fillosofi, Deshmori i Shenjte.*

2. *Nikifori, Ati yne i Shenjte, kryepeshkopi i Kostandinopjes.*